



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË  
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA  
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), te Ligjit, Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", nenit 5, të Ligjit, Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/2008" dhe dispozitave ligjore të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012", i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009, e në mbështetje të neneve 15, 29, pika 2, te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 23.02.2018, miratoj këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

Me këtë vendim formohet komisioni komunal i aksionarëve nga Komuna e Suharekës për Ndërmarrjen Publike Lokale, "Stacionin e Autobusëve" Sh.A, me këtë përbërje të re:

1. Reshat Selimaj----- i emëruar nga Kuvendit Komunës-----anëtar
2. Rilind Krasniqi----- i emëruar nga Kuvendit Komunës-----anëtar
3. Albana Bytyçi-----e emëruara nga Kryetari Komunës-----anëtare

### Neni 2

Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësit e këtij komisioni janë të përcaktuar me Ligjit, Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/2008) dhe dispozitave ligjore të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012) dhe më Ligjin Nr-02/L-123, për Shoqëritë Tregtare, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 39/2008" dhe ligjet tjera që janë në fuqi.

### Neni 3

Për punën që do ta kryej komision do të kompensohen nga 50€, për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbajë, pagesa bëhet nga mjetet vetanake të Ndërmarrjen Publike Lokale "Stacionin e Autobusëve" Sh.A, me seli në Suharekë.

### Neni 4

4.1 Mandat i anëtareve të komisionit komunal të aksionarëve zgjat aq sa zgjat mandati i rregullt i ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Suharekë.  
4.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kur do herë që kërkohet.

### Neni 5


Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ te akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

### Neni 6

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me numër, 01-Nr-16-1188, i datës 24.02.2014, për formimin e komisioni komunal i aksionarëve.

## KUVENDI I KOMUNËS – SUHAREKË

01-Nr-020-8574  
Me datë 26-02-2018.

Kryesuesi i Kuvendit  
  
Bexhet KUÇI